

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Elton Qyno - Syri.net - A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916557/a-do-mbushet-bregdeti-i-semanit-me-parqe-foto-voltaike-sadushi-i-fierit-hap-5-tendera-per-dhenie-me-qira-te-391-mije-m2-toke/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 11:56:47 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 11:53:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5adcb9457ee018e2b938d5c5b2befc3dc28d96e8d3556f65f6411a4a1d9f2915
TEKSTI	cea60beb22c12d106dc1aad20876b5b10ddcb6f8e114e9c3cec63df34df6c099
PAMJA	fe78a172ef0cdad5e3e2a0bd18d5620689bd66d889b4fc5a20b58c8e468b9a46

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ee045a963e210b91e62c8fc3d72d82db463c049112620826fc04b1f3509b6136
E MËPARSHMJA	c874e9d56cfd52aed77dd7c202cbf2ba53338317355d2ff0b9131fe63ae43f80
RRËNJA MERKLE	0b6439cf09af002ac6f6fba878872d12e4fabe601bb852ed9a98adac17b7c4e3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ee045a963e210b91e62c8fc3d72d82db463c049112620826fc04b1f3509b6136>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**IRENA BEQIRAJ**Fashizmi nuk duhet kërkuar
tek revolta e protestuesve por
në Kuvend!**AGIM XHAFKA**

Dialog me mbesën



më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatorë

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhdukët historia



A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

13:53, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Elton Qyno - Syri.net

Përmes 5 procedurave tenderuese të hapura në Ditën e parë të Shkollës, kryetari i bashkisë Fier, Armando Subashi, i ka ndezur dritën jeshile një praktike për dhënies me qera për një periudhë 20 vjeçare, të 5 sipërfaqeve tokësore në Sheq Marinas dhe Grykë, fshatra këto bregdetarë që i përkasin njësisë administrative Topojë, Fier.

Gazetari Elton Qyno, ka mësuar se bëhet fjalë për një sipërfaqe totale prej më shumë se 391 mijë metra katror, që Bashkia Fier ka nxjerrë procedurë tenderuese, me qëllim dhënien me qera tek privatët për ushtrim të kativitetit tregtar në fusha të ndryshme.

Sipas dokumentave të siguruar, 5 pasuritë të llojit ranishte dhe tokë pa frut, janë në pronësi të bashkisë Fier, ndaj dhe sot është hedhur procedura për dhënien me qera të tyre për një aaft 20 vjeçar.

Të gjitha sipërfaqet prej 109.800 m2, 76.000 m2, 76.443 m2, 68.835 m2 dhe 60.000 m2, ndodhen në zonën bregdetare të Adriatikut, dhe shumë pranë grykëderdhjes së lumit Seman.

Ndërkohë vlera financiare dysheme që ka përllogaritur bashkia e Fierit për pagesë 1 hektarë në vit, është vetëm 270 mijë lekë të vjetra.

Vlera e fundit sipërfaqe të tëra tokë të kësi zone, janë marrë dhe mbi to subjekte

viere e turrit sipërfaqe të tëra të reja të reja, janë marrë dhe mbi të subjektet private kanë ndërtuar parke FotoVoltaikë me panele diellore.

Me sa duket, e njëjta situata synohet të bëhet edhe në këtë rast. Ku privatëve do u ofrohet me qera nga ana e bashkisë Fier 391 mijë m2 tokë dhe më pas subjektet e interesuara do ndërtojnë aty panelet diellore.

Kjo procedurë është në hapat e parë dhe pritet që ajo të mbyllet me dorëzimin e ofertave për subjektet e interesuara deri në datën 25 shtator 2026.

Pas këtij afati një Komision i Vlerësimit të Ofertave i ngritur në bashkinë e Fierit, do vendosi për caktimin e subjekteve fituese në 5 pasuritë që synohet të jepen me qera nga bashkia e Fierit.

BASHKIA FIER NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54 dt. 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiletoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 101 dt. 19.12.2017, nr. 99 dt. 31.10.2022 dhe nr. 53 dt. 17.05.2023 "Për miratimin e fillimit të procedurave për dhënien me qira të sipërfaqeve "tokë pa frut", të ndodhura në fshatin Sheq Marinas dhe Grykë, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier", Bashkia Fier do të realizojë procedurën për dhënien me qira me konkurim të pasurisë nr. 10/7 zk. 3358 me sipërfaqje 76 443 m² "tokë pa frut", Bashkia Fier, pronë e Bashkisë Fier. Dhënia me qira e pasurisë jepet me qëllim ushtrimin e aktivitetit në fusha të ndryshme sipas përcaktimeve të VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiletoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 943/982

Buletini Nr. 57 datë 14 Shtator 2026

Agjencia e Prokurimit Publik

Vlera dysheme per detyrimin e qirase per fillimin e ankandit do te jete 27 000 leke ha/vit.

Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie është deri 20 vjet.

Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- | | |
|---|---------|
| c) Niveli i investimit | 30 pike |
| b) Niveli i punësimit | 10 pike |
| c) Pervoja në fushën e aktivitetit që do të ushtrohet | 5 pike |
| d) Oferta e detyrimit mujor të qirase | 55 pike |

Konkurimi do të zhvillohet në dt. 25.09.2026 ora 11.00 në Bashkinë Fier sipas procedurave të parashikuara në VKM nr. 54 dt. 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiletoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar. Në ngarkim të "Qiramarrësit" janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira sipas legjislacionit në fuqi.

Konkurentët do të dërgojnë në adresën zyrtare elektronike të institucionit info@bashkiafier.gov.al, në datën dhe orën e caktuar, deri në dt. 25.09.2026 ora 11.00 dokumentacionin si vijon:

- Kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore;
- Planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksion të objektit, ku të përshkruhen qartë, plani i punësimit, plani i investimeve si dhe treguesit që do të realizohen;
- Ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirase;
- Certifikatën e regjistrimit dhe certifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR;
- NUIS – in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore;
- Vërtetime nga institucionet përkatëse që nuk është në ndjekje penale, si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin.

2 / 2

© SYRI.net

Lexo edhe:



A do e lëshojë Rama, Ballukun? Berisha: Ka një tension real midis tyre pas arrestimit të Agasit



Berisha: Nuk kisha asgjë personale në përpjekjen time për një opozitë të pavarur. Kisha vetëm interes kombëtar



Keqkuptimi me takimet e së premtes!

TË NGJASHME



Berisha: Nuk kam qenë kurrë 'non grata'! Ata që u morën me këtë çështje kanë marrë ndëshkimin e merituar nga McConical të Voti Kim



Berisha: Denoncoj me forcën më të madhe kërcënimet ndaj gruas dhe familjarëve të Ahmetajt me urdhër të Durrës



Berisha: Të gjitha problemet që denoncuam ne janë thënë edhe në seancën dëgjimore të Kongresit amerikan




Berisha: Diaspora na rezervoi një pritje të jashtëzakonshme. Ajo është gati të bëjë gjithçka për të ngritur në këmbë Shqipërinë

'Po blejnë influencë të zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin e tyre

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës! Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar! Dita e 105 e protestës në foto

meditimi, nga mesazhet e tilla nga e Blinken



Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës! Mediat proqeveritare e censuruan fjalën e tij

meditimi



Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Rama! Shqipëria, parcelë eksperimentale e Sorosit

meditimi



Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet! Famëzinjtë Balluku, Rama, Agasi, Lindat...

perspektivë e këmbës shqiptare

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.